



Numri ynë: _____
_____.2024
Shkup

Në bazë të Nenit 50 paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 05/02), dhe në lidhje me Nenin 29 paragrafi 3 të Ligjit për Kulturë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 31/98, 49/03, 82/05, 24/07, 116/10, 47/11, 51/11, 136/12, 23/13, 187/13, 44/14, 61/15, 154/15, 39/16, 11/18 dhe 11/18), dhe në përputhje me Nenin 45 paragrafi 3 të Ligjit për Institucionet ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 32/05, 120/05, 51/11 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 99/22) dhe Nenit 26 dhe 27 të Statutit të Institucionit Publik Shtëpia e Kulturës "Koço Racin" – Shkup nr. 01-105/4 të datës 10.04.2019, Kryetarja e Qytetit të Shkupit shpall

SHPALLJE PUBLIKE
për zgjedhjen e drejtorit të Institucionit Publik
Shtëpia e Kulturës "Koço Racin" – Shkup

1. Kandidati duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- në momentin e zgjedhjes me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk i është shqiptuar dënim ose kundërvajtje, ndalim për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- të ketë fituar më së paku 240 kredi sipas EKTS ose të ketë përfunduar shkallën VII/1 të arsimit të lartë të përcaktuar me statutin e institucionit;
- ka minimum pesë vjet stazh pune në fushën e kulturës ose pesë vjet eksperiencë pune në punë ose projekte në fushën e kulturës në bazë të kontratave për punë;
- ka një nga certifikatat e mëposhtme të njohura ndërkombëtarisht ose vërtetime për njohjen aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:

- TOEFEL IBT – më së paku 74 pikë,
- IELTS - më së paku 6 pikë,
- ILEC (Cambridge English: Legal) - më së paku nivel B2 (B2),
- FCE (Cambridge English: First) – të përfunduar
- BULATS - më së paku 60 pikë ose
- APTIS - më së paku nivel B2 (B2)

2. Kandidati është i obliguar që përveç dëshmive për plotësimin e kushteve të lartpërmendura të depozitojë edhe dokumentet e mëposhtme:

- Fletëparaqitje me biografi të shkurtër
- Propozim-Program për punën dhe zhvillimin e institucionit

3. Dokumentacionin e nevojshëm kandidati është i obliguar ta depozitojë në origjinal ose kopje të vërtetuar te noteri.

4. Afati për depozitimin e dokumentacionit të nevojshëm është 15 ditë pune, nga dita e shpalljes së Shpalljes publike në shtypin e ditës.

5. Dokumentacioni i depozituar jashtë afatit të caktuar, i paplotë dhe i parregullt nuk do të jetë lëndë e shqyrtimit. Fletëparaqitjet për Shpalljen publike depozitohen në adresën e mëposhtme:

Institucioni Publik Shtëpia e Kulturës “Koço Racin” – Shkup - Këshilli Drejtues
(për Shpalljen publike për zgjedhjen e drejtorit)

Adresa e institucionit: rr. „Dimitrija Çupovski “ nr. 20a
1000 Shkup, R. e Maqedonisë

Qyteti i Shkupit
Kryetarja

Danela Arsovska

